




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHITES
MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION

OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga mbledhja e jashtëzakonshme Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), e mbajtur më 22 maj 2025, në ora 14:30, në sallën e vogël të Komunës së Shtimes.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Nënkryetari i Komunës, Faruk Beqa, komandanti i Stacionit Policor në Shtime, Haxhi Behluli, Skender Dauti (KSH), Osman Zeqiraj (FSK), Albert Ramadani (KLSP), Xhavit Bungu (KP), Muhamet Muhameti (ZKKK), Jener Fazliu (QPS), Shpresim Mahmuti (OJQ), Mimoza Qeriqi (DSHMS), Lulzim Sahiti (DKA), Vlora Hyseni (ZI) dhe Agnesa Ademaj (ZI)

Nënkryetari i Komunës z. Beqa merr fjalën dhe falënderon të pranishmit që janë prezent në këtë mbledhje dhe prezanton pikën e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i situatës së krijuar për rastin e SH. LI

Faruk Beqa: Atëherë, edhe një herë, mirë se keni ardhur të gjithë! Siç e keni parë edhe në ftesë, ky është një takim i jashtëzakonshëm i Këshillit Komunal për Bashkësi dhe Siguri, me një pikë të rendit të ditës. Paraprakisht kemi biseduar me akterët e sigurisë dhe kemi ardhur në përfundimin se duhet të shqyrtojmë çështjen e një personi këtu, i cili ka kryer një mori veprash dhe po shfaqet

me agresivitet. Në fillim, janë ndërmarrë disa masa për të, konkretisht mbajtja e tij në Spital, por ata kanë vendosur ta lëshojnë. Ky djalë nuk është i keq, megjithatë unë nuk kam kompetencë të jap një diagnozë. Fatkeqësisht, ai është nën ndikimin e narkotikëve dhe sot ka qenë edhe këtu, duke shkaktuar shqetësime. Kemi frikë se sjelljet e tij mund të eskalojnë, pasi po bëhet gjithnjë e më agresiv.

Fillimisht kemi menduar të marrim masa urgjente përmes një mekanizmi tjetër, por na kushtëzuan. Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është konsultuar me zyrtarin ligjor, dhe kjo nënkupton që sot duhet të dalim me një rekomandim. Ideja është të rekomandojmë që prokuroria në Ferizaj të ndërmarrë masat e nevojshme për këtë person, deri në trajtimin dhe shërimin e tij, në mënyrë që të mos përbëjë rrezik për qytetarët tanë. Meqë të gjithë jemi kompetentë në këtë çështje, hap diskutimin. Po Skender?

Skender Dauti: Unë këtë personin nuk e njoh personalisht, por e njoh prindin e tij. Vitin e kaluar në shtator ai kërkoi ndihmë, pasi nuk dinte ku të drejtohej, dhe unë e orientova te neuropsikiatri Afrim Blyta. Ai ka rënë pre e personave që nuk ia duan të mirën, as atij dhe as familjes së tij.

Si person, ai është i dashur, por nën ndikimin e narkotikëve ka nevojë për trajtim nga institucioni përkatës. Prindi i tij më ka thënë se, kur është në terapi, ai është shumë mirë, por nuk ka mundësi t'ia sigurojë tabletat që duhet të marrë vazhdimisht, sepse nuk mundet t'i rrijë pranë. Po flas për vitin e kaluar ai ka nevojë për ndihmë edhe nga ne si institucione shëndetësore për të marrë terapinë e duhur, përndryshe mund të vijë një moment kur terapia nuk do të ndihmojë më. Ai nën përdorimin e narkotikëve, ka rënë pre e këtyre sjelljeve. Besoj se policia tashmë ka informata të detajuara.

Faruk Beqa: Po Skender, afërsisht kështu qëndron situata. Ftoj komandantin e policisë që të na informojë më shumë.

Haxhi Behluli: Faleminderit nënkryetar. Ky është një takim emergjent, dhe siç e theksoi nënkryetari, është shumë e rëndësishme që të punojmë së bashku për të nxjerrë një rekomandim me idetë më të mira dhe të jemi të përgatitur. Me respektin që kemi për të gjithë qytetarët, dua të bëj një pasqyrë të shkurtër që të jeni të informuar për situatën me të cilën po përballemi. Situata e tij është e pakontrollueshme, personi nuk është në gjendje të kontrollojë veten për shkak të gjendjes së tij. Kohët e fundit ka qenë një shqetësim, si për ne, ashtu edhe për qytetarët, dhe kanë ardhur

ankesa nga disa qarqe të caktuara. Jemi munduar ta trajtojmë çështjen në mënyrë të kujdesshme dhe jo me karakter mediatik. Ka pasur raste kur më kanë kërkuar të jap intervistë për këtë situatë, por kam preferuar ta refuzoj, pasi bëhet fjalë për një person që ka familje dhe duhet trajtuar me kujdes. Ky individ ka lëvizur në qytete të ndryshme si Suharekë, Prizren dhe Prishtinë, i pakontrolluar. Policia e ka identifikuar dhe ne kemi ndërhyrë për ta ndaluar. Ka marrë vetura pa lejen e pronarëve, i ka dëmtuar, ka kryer dhunë në familje dhe një sulm së fundmi. Deri më tani kemi trajtuar tre raste me prokurorinë, ku i fundit është ai i marrjes së veturës. Prokuroria ka vendosur ta ndalojë për 48 orë. Edhe pse kemi kërkuar që ai të dërgohet në ekzaminim psikiatrik, prokuroria nuk e ka pranuar këtë kërkesë.

Nga vlerësimet që kemi bërë, ky person ka nevojë për ndihmë psikiatrike, dhe këtë e kanë konfirmuar edhe kolegët që e njohin. Ata mendojnë se ai nuk duhet të trajtohet më këtu, por të dërgohet në psikiatri forenzike. Problemi është se prokuroria publike duhet të na ndihmojë, por edhe policia e ka një kufizim në atë se çfarë mund të referojë tek gjykata. Kjo e bën çështjen të vështirë, pasi as prokurori nuk mund ta dërgojë atë në psikiatri forenzike pa një trajtim të specifikuar.

Me pëlqimin e prindërve, përmes nesh, ai mund të dërgohet në gjykatë me një rekomandim ku do të theksohen pikat e rëndësishme. Kjo do të ndihmonte nëse do të përfshihej edhe Ministria e Shëndetësisë në trajtimin e tij. Psikiatria ka konfirmuar se ai është adresuar në repartin përkatës, por ai qëndron aty vetëm me vullnetin e tij dhe deri më tani nuk ka qëndruar dhe ka ikur. Shqetësimi i madh mbetet edhe për të ardhmen, pasi ai mund të lëndojë të tjerët për shkak të gjendjes së tij të pakontrollueshme, me raste të dhunës dhe marrjes së automjeteve. Këtë vlerësim e kemi dërguar edhe në prokurori, dhe kushdo që ka një ide të mirë mbi trajtimin e tij është i mirëpritur ta ndajë.

Për të mos zgjatur më shumë, ky djalë duhet të rehabilitohet jo për një apo dy javë, por për një trajtim më të gjatë, pasi edhe tre muaj mund të mos jenë të mjaftueshëm. Duke u bazuar në sjelljet e tij dhe rastet e trajtuara në stacionin policor, mendoj se ky person nuk mund të jetë i lirë dhe duhet të trajtohet. Po ashtu, kemi edhe raste të tjera që mund të bashkëngjiten në rekomandim. Ju faleminderit!

Faruk Beqa: Ju faleminderit, komandant! A ka dikush që dëshiron të shtojë diçka, po drejtoreshë?

Mimoza Salihu: Përshëndetje për të gjithë! Ashtu siç e theksoi edhe komandanti, kemi diskutuar mbi këtë çështje dhe kam marrë një kërkesë nga prindi, z. Llugagjiu. Ai ka bërë një kërkesë zyrtare në Ministrinë e Shëndetësisë për trajtimin e djalit të tij. Rekomandimi që do të dalë sot nga KKSB duhet t'i bashkëngjitet kësaj kërkesë, si dhe raportet nga komandanti i policisë. Prindi i tij thekson se djali i tij ka nevojë për rehabilitim, pasi po shkakton shumë dhunë, si në familje ashtu edhe në shoqëri. Komandanti i përmendi të gjitha pikat kryesore dhe ndërsa prindi fillimisht ka bërë kërkesë verbale, tani e kemi edhe një kërkesë me shkrim, që do t'i bashkëngjitet rekomandimit tonë.

Rehabilitimi i tij mund të bëhet në klinikat e psikiatrisë ose, në rastin e tij, mund të shqyrtohet edhe mundësia e qëndrimit në burgun e Dubravës, siç e kemi diskutuar me komandantin. Ndoshta dikush ka informacion mbi praktikatat më të lehta për trajtimin e këtij rasti dhe mënyrat për ta larguar atë nga shoqëria.

Skender Dauti: Do të ishte e dobishme që institucionet përkatëse të kenë informacione mbi momentin kur ky person ka filluar të përdorë substanca narkotike, cilat substanca ka përdorur dhe në fund të përcaktojmë diagnozën mbi bazën e së cilës do të rekomandojmë trajtimin. Nuk mundet një person të trajtohet në një klinikë pa diagnozë të qartë.

Fillimisht, ai është trajtuar psikologjikisht, por më pas ka rënë pre e ndikimit të substancave. Policia i ka të dhënat e tij, por deri tani nuk është adresuar nga askush në mënyrë të plotë.

Faruk Beqa: Faleminderit Skender, dikush tjetër? Po Xhavit?

Xhavit Bungu: Përshëndetje për të gjithë! Unë kam pasur raste me persona që kanë qenë nën ndikimin e substancave, por janë shëruar. Megjithatë, nuk më ka rënë të kem kontakt me këtë person, nuk e njoh as atë e as prindin e tij. Nuk e di as sa vjeç është, apo nëse është i martuar ose i fejuar pra, nuk e njoh fare statusin e tij.

Shpresim Mahmuti: Ai është 24 vjeç.

Xhavit Bungu: 24 vjeç, pra! Nëse është i martuar, problemi mund të jetë edhe më kompleks, sepse mund të ketë edhe çështje familjare. Mund të ndodhë që të përpiqet të manipulojë situatën dhe ta

paraqesë sikur nuk është në rregull, kur në fakt ka probleme me të fejuarën dhe familjen. Këto sjellje nuk kanë lidhje me të tjerët, por ai i ka zhvilluar për shkak të mbidozës dhe fakti që edhe prindërit e tij po kërkojnë ndihmë, tregon se situata është shumë serioze sepse ata nuk mund ta trajtojnë më vetë.

Faruk Beqa: E saktë! Ne edhe më herët kemi bërë rekomandime për dy raste, por tani duhet të dalim me konkluzione dhe të marrim hapin e radhës.

Drejtoreshë dhe Lulzim, kush duhet të hartojë rekomandimin për prokurorinë në Ferizaj, gjykatën dhe Ministrinë e Shëndetësisë?

Lulzim Sahiti: Kjo i takon digasterit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, por duhet që edhe ne ta mbështesim këtë proces.

Faruk Beqa: Po, situata është shumë serioze dhe mund të shkaktojë një incident të rëndë i cili mund të jetë i pakthyeshëm.

Xhavit Bungu: Duhet të ndërmerren masa sa më shpejt, që të mos presim të ndodhë një problem i madh. Ky person mund të shkaktojë një incident të rëndë, për shembull mund të shtyjë dikë nga një urë, dhe në atë moment, problemi do të jetë i pariparueshëm. Duhet të veprojmë përpara se të ndodhë diçka më e rëndë.

Haxhi Behluli: Edhe pse kemi juristë këtu, dua të theksoj disa çështje. Ne e dimë mirë që ky individ ka pasur një rast në vitin 2014. Nuk po paragjykoj nëse atëherë ka qenë nën ndikimin e substancave ose ka pasur probleme psikike, por ai ishte i ri. Nga të dhënat që kam marrë nga kolegët në vitet 2020-21, gjendja e tij ishte e njëjtë. Disa kolegë që e kanë trajtuar janë befasuar, sepse kur ka shkuar në trajtim ai ishte më i dëgjueshëm se tani d.m.th i dëgjonte prindërit, policinë dhe shoqërinë duke pranuar trajtimin. Pas trajtimit, nuk ka pasur më probleme, por tani nën ndikimin e narkotikëve, situata ka ndryshuar në muajin e fundit.

Policia e njeh mirë dhe ky person nuk po aktron, nuk po vepron ndryshe vetëm për t'u dukur. Ai ka ngarkesë psikiatrike dhe duhet trajtuar nga mjekët. Nëse dikush e ndalon dhe komunikon me të, ai është bashkëpunues, por veprimet që kryen janë në gjendje të pavetëdijshme. Ai ka arritur të marrë dy automjete dhe t'i dërgojë deri në Prizren. Edhe pse nuk ka humbur rrugën, ka shkatërruar veturat dhe ka vozitur sipas dëshirës së tij.

Kjo është pasojë e substancave narkotike, dhe prokuroria ka vështirësi ta dërgojë atë në psikiatri, pasi merret me raste edhe më të rënda. Për shembull, kemi pasur një rast në Ferizaj ku një person nga kati i tetë i një ndërtese i ka vënë kusht policisë se ose do të hidhte fëmijën, ose do të vriste veten. Në atë rast, u mor menjëherë masa dhe personi u dërgua në psikiatrinë forenzike. Por në këtë rast, prokuroria nuk ka dhënë të njëjtin vendim, edhe pse ne kemi bërë presion me shkresa dhe letra.

Ndoshta ata druajnë se mund të gabojmë duke bërë një kërkesë për gjykatësin, pasi ky person nuk ka arritur ende në shkallën ekstreme të problemeve psiqike. Ligji na kufizon, dhe ne duhet të jemi të kujdesshëm. Kemi autorizuar edhe hetuesit që të pasqyrojnë gjendjen e tij si lëviz, çfarë vepron, dhe më pas do t'i ndihmojmë rekomandimin që ky individ të trajtohet për rehabilitim. Nëse do të kishim një institucion ku ai mund të trajtohej dhe policia ta mbikëqyrte, do ta bënim këtë, por fatkeqësisht, nuk ekziston një strukturë e tillë. Më falni nëse e zgjata pak, por qëllimi është të gjejmë një zgjidhje.

Faruk Beqa: Në rregull, faleminderit! A shkojmë drejt realizimit të rekomandimit? Besoj që komandanti e ka edhe një shkresë që mund t'ia bashkëngjisim. Është e rëndësishme që drejtoresha ta marrë përsipër hartimin e rekomandimit. Nëse nuk bëhet sot, duhet të bëhet nesër në mëngjes. Qëllimi është që përmes këtij rekomandimi prokuroria dhe gjykata në Ferizaj të marrin një vendim në favor të kërkesës sonë dhe të prindërve të tij. E njëjta shkresë duhet t'i dërgohet edhe Ministrisë së Shëndetësisë në mënyrë që ata të jenë të informuar dhe të mundësojnë trajtimin për shërim.

Haxhi Behluli: Kjo e fuqizon rekomandimin akoma më shumë. Prokuroria dhe gjykata marrin shumë seriozisht një vendim të Qendrës Sociale, prandaj edhe ata mund të bashkëngjisin një raport mbi gjendjen familjare të personit. Nëse Qendra ka ndonjë raport, do të ishte mirë ta përfshijmë në dokument.

Jener Fazliu: Sipas prindit, ky është përdorues i substancave narkotike. Mendoj se nëse i bashkëngjisim të gjitha këto informacione, prokuroria ka bazë të mjaftueshme për të marrë vendimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Lulzim Sahiti: Vetëm fakti që ai ka marrë një automjet dhe ka shkuar në Prizren, duke vozitur me shpejtësi të lartë, tregon se ka shkaktuar rrezik në komunikacion. Kur të ndodh një aksident me pasojë të rënda prokuroria nuk mund të ndërhyjë më, sepse policia vepron vet pastaj.

Faruk Beqa: Keni të drejtë! Dua vetëm të shtoj që shkresa e rekomandimit duhet të jetë shumë e fuqishme. Dje e pashë personalisht këtë person në një kafene, ku u drejtohej fëmijëve me gjeste kërcënuese, sikur po u thoshte se do t'i vriste. Mund të ndodhë një incident i rëndë që nuk do të falet.

Lulzim Sahiti: Në këtë rekomandim duhet të përfshijmë të gjitha faktet që kemi përmendur dhe të paraqesim rrezikshmërinë që ky individ përbën për qytetarët. Drejtoresha i ka tashmë raportet e policisë, dhe vetëm fakti që ka marrë një makinë pa leje është një vepër penale. Nuk e kuptoj pse ende diskutohet ky rast.

Ky person nuk është i keq, është një djalë i mirë, por substancat narkotike e kanë sjellë në këtë gjendje. Madje ai ka shkuar edhe në çerdhe, duke pretenduar se është inspektor për të marrë informacione.

Jener Fazliu: Mund të marrim edhe një shkresë nga çerdhja dhe ta bashkëngjisim në dokumentin zyrtar.

Faruk Beqa: Në rregull! Po e konkludoj që drejtoresha duhet të hartojë rekomandimin me ndihmën tonë, Policisë, Drejtorisë së Arsimit, Qendrës për Punë Sociale dhe Zyrës së Informimit. Ky dokument duhet të finalizohet nesër në mëngjes, rreth orës 10:00, që të mos vonohemi shumë për këtë rast. Ideja është që rekomandimi të plotësohet me të gjitha faktet dhe me mbështetjen time si drejtues i KKSB dhe si nënkryetar.

Ju faleminderit shumë për kontributin! Mirupafshim në takimet e radhës

Mbledhja përfundoi në ora : 15:15














Procesmbajtëse:

Vlora Hyseni

**LISTA E PJESËMARRËSVE PËR MBLEDHJE TË JASHTZAKONSHME TË KËSHILLIT
KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

Shtime, 22 maj 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Shënoder Kauti	h. shtime	
2	Osmom Jeginaj	FSK	
3	HAXH BEHLIU	RUCIA E KASOVË	
4	ARUK BEOA	NEKRYETAR	
5	Albert Parnadani	KLSP-SHTIME	
6	Yhavit Bunga	KP Shtime	
7	Muhamet Muhamedi	ZKKK Shtime	
8	JEMER FAELICI	QPS SHTIME	
9	Shpresim Mahmuti	Mësimdhënës	
10	Mimoza Zella Berzi	DEHMO SHTIME	
11	Agnesa Ademaj	Zyra për Informim	
12	Lulzim Sahiti	DKA	
13	Mlora Hyrene	Z. Informimit	
14			
15			
16			
17			